

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal**, Gjyqtari i vetëm gjykues, Gazmend Bahtiri, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Mihrie Sheholli, në çështjen penale kundër të akuzuarit B.S. nga P., rruga “...” pn. për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.8 lidhur me par.6 dhe par. 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, PP.nr.4756/2010 dt.23.11.2010, pas mbajtjes së seancës të shqyrtimit fillestar me datë 16.02.2015, në praninë e Prokurorit të Shtetit Enver Krasniqi, të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij sipas autorizimit av. A.V. nga P., mori dhe publikisht shpalli aktgjykimin, përpilimi i aktgjykimit u bë konform nenit 370 të KPRK-së, me datë 05.03.2015:

**A K T G J Y K I M**

**I akuzuari B.S.**, i biri i S. dhe nënës S., e vajzërisë M., i lindur më *data e lindjes...*, i lindur në Split Republika e K. tani me vendbanim në P., rruga “...” pn., me numër personal të identifikimit: *numri personal...*, ka të kryer Fakultetin Ekonomik, me profesion Ekonomist, punon në Firmën Petrol Company si Menagjer, i gjendjes së mesme ekonomike, i martuar, pa të dhëna se më parë ka qenë i gjykuar i dënuar, kundër tij nuk zhvillohet procedurë tjetër penale, Shqiptarë-Shtetas i Republikës së Kosovës, ka qëndruar në arrest shtëpiak prej datës **31.10.2010 në kohëzgjatje 30 (tridhjetë ditësh)**.

**Ë S H T Ë F A J T O R**

**Sepse:**

Me datë 31.10.2010, rreth orës 09:45min,në magjistralen P.-P., afër lokalit te “Mani” afër pompës për derivate “Kosova Petrol”,derisa i pandehuri pa Patent Shofer ishte duke e drejtuar veturën e tipit “Xhip Captiva”, ngjyrë e zezë metalike, me targa të regjistrimit *targat e regjistrimit...*, në drejtim të M., duke mos ju përshtatur kushteve në rrugë dhe pjesëmarrësve tjerë në trafik në kundërshtim me nenin 54 të LSKRR, nga pakujdesia ka rrezikuar trafikun publik, jetën e njerëzve, në atë mënyrë që i pandehuri ka lëvizur me një shpejtësi të madhe prej 87.36 km/h, në vendin ku shpejtësia është e kufizuar me 60Km/h, duke marr vendimin e tejkalimit pa u siguruar mirë se një veprim të tillë mund

ta ndërmerr pa e dëmtuar askënd, ashtu që gjatë tejkalimit të veturës “VW Golf 1HX0”, ngjyrë e kuqe, me targa të regjistrimit *targat e regjistrimit...*, të cilën e drejtonte i dëmtuari S.P., i cili ishte në të njëjtin drejtim dhe në pamundësi të tejkalimit në pjesën anësore të majtë e godet veturës “VW Golf 19E” ngjyrë hiri metalike, me targa të regjistrimit *targat e regjistrimit...*, të cilën e drejtonte i dëmtuari F.J., në drejtimin e kundërt të lëvizjes së automjeteve, me ç’rast të njëjtit i ka shkaktuar lëndime të rënda trupore, e pastaj e godet edhe veturën “Golf 1HX0”, duke ju shkaktuar lëndime të lehta trupore të dëmtuarëve në veturë: L., F., F. dhe S.P.

-Me këtë ka kryer veprën penale Rrezikim i Trafikut Publik nga neni 378 par. 8 lidhur me par 6 dhe 1 të KPRK-së.

Prandaj, gjykata në bazë të neneve 4,17,23,41,42,43,45,73,83 par.1, nenit 378 par. 8 lidhur me par. 6 dhe 1 të KPRK-së, si dhe në bazë të neneve 365,450,453,463 të KPPRK-së, e

## G J Y K O N

**I.** Të akuzuarin B. (S.) S., me dënim me burg, ashtu që i shqipton dënim me burg në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, të cilin do ta vuaj pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

**II.** Konform nenit 83 par. 1 të KPRK-së, në dënimin e shqiptuar i llogaritet edhe koha e kaluar në arrest shtëpiak në kohëzgjatje prej 30 ditësh, prej datës **31.10.2010**.

**III.** Detyrohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguajë shumën prej **153.3€**, (për pesë ekspertiza mjeko-ligjore), dhe shumën prej **40.88€**, (për një ekspertizë të komunikacionit) si dhe në emër të shpenzimeve paushalle të paguajë shumën prej **100€**, në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

**VI.** Të dëmtuarit: F. J. nga fshati Sh. KK P., L., F., F. dhe S.P. që të gjithë nga fshati Ll. KK P., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohen në kontestin e rregullt juridiko-civil.

Pas shpalljes së aktgjykimit, gjykata konform nenit 47 të KPRK-së, me pëlqimin e personit të dënuar, dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, duke iu llogaritur edhe koha e kaluar në arrest shtëpiak prej 30 ditësh, i zëvendësohet me dënim me gjobë në shumë prej **2500 euro**, (**dymijë e pesëqind euro**) të cilin dënim është i obliguar ta paguaj brenda afatit prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e në rast se nuk e paguan mbetet në fuqi dënimi me burgim.

## A r s y e t i m

PPK në Prishtinë, tani Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur Aktakuzën PP.nr.4756/2010 dt.23.11.2010, kundër të akuzuarit B.S. nga P., rruga "...” pn, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 297 par. 1 dhe 3 lidhur me par. 5 të KPK-së.

Lidhur me këtë çështje penale gjykata mbajti seancën e shqyrtimit fillestar më dt. 16.02.2015, gjatë së cilës u dëgjuan Prokurori i shtetit, i akuzuari dhe mbrojtësi i tij.

I akuzuari në seancën e shqyrtimit fillestarë pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij av. A.V., ka deklaruar se në tërësi e pranon fajësinë për të gjitha pikat e Aktakuzës, duke shtuar se ndien keqardhje për të dëmtuarin, e për të cilin është interesuar vazhdimisht për shëndetin e tij, dhe ka theksuar se e ka ndihmuar për shërim në Shkup sa ka qëndruar për dy javë me të gjitha shpenzimet në shumë prej 26.000 euro.

Prokurori i shtetit në seancën e shqyrtimit fillestar fillimisht e ka bërë plotësimin e dispozitivit të aktakuzës me dispozitën blankete të nenit 54 të LSKRR, dhe lidhur me pranimin e fajësisë ka dhënë mendimin se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, duke konsideruar se pranimi i fajësisë është bërë në pajtim me nenin 248 të Kodit të Procedurës Penale.

Mbrojtësi i të akuzuarit av.A.V. në seancën e shqyrtimit fillestar lidhur me pranimin e fajësisë ka dhënë mendimin se e përkrah pranimin e fajësisë nga i mbrojturi i tij dhe se pranimi i fajësisë është konform nenit 248 të Kodit të Procedurës penale dhe ka kërkuar nga gjykata që gjatë shqyrtimit të dënimit pranimi i fajësisë, mosha, pakujdesia të merren si rrethanë lehtësuese, dhe brenda mundësive ligjore që ti shqiptohet një dënim me kusht.

Gjyqtari i vetëm gjykues vërteton se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimi i fajësisë u bë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit për plotësimin e aktakuzës të pranuar edhe nga i akuzuari dhe çdo provë tjetër dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabime faktike.

Gjykata pas pranimin të fajësisë nga ana e të akuzuarit, si dhe marrjes së mendimit të palëve, respektivisht prokurorit të shtetit dhe mbrojtësit të akuzuarit si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës vërteton se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore të parapara sipas dispozitës së nenit 248 par. 1 të KPPRK-së, dhe e aprovoi pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në shqyrtimin fillestar, andaj gjykata konform nenit 248 par.4 të KPPRK-së, nuk ka zbatuar procedurën e provave por ka vazhduar me shqyrtimin e dënimit.

Pasi që i akuzuari e pranoi fajësinë vullnetarisht, gjykata e vlerësoi dhe analizoi se pranimi i fajësisë ka mbështetje në mendimin dhe konstatimin e ekspertit të

komunikacionit rrugor Ing. A.K. të datës 12.11.2010. Përveç këtij konstatimi të kësaj gjendje faktike të pakontestueshme, pranimi i fajësisë ka mbështetje edhe në mendimin e ekspertit mjeko-ligjor Dr. N.H., të datës 05.11.2010, lidhur me lëndimet e të dëmtuarve: F.J., L., F., F. dhe S.P. si dhe në fotodokumentacionin dhe skicën e vendit të ngjarjes.

Gjykata duke vepruar sipas detyrës zyrtare zbaton ligjin më të favorshëm në kuptim të nenit 3 par.2 të KPRK-së, i cili ka hyrë në fuqi me 01.janar.2013, është më i favorshëm për arsye se është paraparë mundësia e zëvendësimit të dënimit me burgim në dënim me gjobë deri në gjashtë (6) muaj, për dallim nga kodi i mëparshëm që ka qenë vetëm deri tre (3) muaj burg, mbi këtë bazë u bë rikualifikimi dhe atë: nga vepra penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 297 par. 1 dhe 3 lidhur me par. 5 të KPK-së, në veprë penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 8 lidhur me par. 6 dhe par. 1 të KPRK-së.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar edhe nga vet i akuzuari, gjykata vërteton se me veprimet inkriminuese të akuzuarit me shkelje të nenit 54 të LSKRR, përmbushen të gjitha elementet qenësore të veprës penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 8 lidhur me par.6 dhe par.1 të KPRK-së.

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se i akuzuari e ka kryer veprën nga pakujdesia, duke mos i kushtuar vëmendje të mjaftueshme kushteve dhe pjesëmarrësve tjerë në trafik, për çka edhe është shkaktuar aksidenti.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqit rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësinë penale të akuzuarit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara me nenin 73 të KPRK-së, dhe në rastin konkret si rrethana lehtësuese gjeti vetëm faktin se i akuzuari B.S. gjatë shqyrtimit fillestar e ka pranuar në tërësi fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, kishte sjellje korrekte dhe ndien shumë keqardhje për të dëmtuarin, duke e ndihmuar financiarisht për shërim, i moshës së re, për herë të parë ka ra në kundërshtim me ligjin, të gjitha këto rrethana kjo gjykatë i ka pranuar si rrethana lehtësuese në dobi të akuzuarit. Duke e marrë parasysh shkallën e përgjegjësisë penale, si rrethana veçanërisht rënduese gjykata gjeti se i akuzuari ka drejtuar automjetin “Chevorlet Captiva” pa qenë i pajisur me Patentë Shofer e që ka rezultuar se i kanë munguar njohuritë elementare të rregullave të komunikacionit, andaj duke vlerësuar këto rrethana, gjykata të akuzuarin e gjykoj si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Kjo veprë penale është shumë e shpeshtë në vendin tonë, vetëm për shkak të mos mosrespektimit të rregullave të komunikacionit. Dhe kjo gjykatë konsideron se dënimet e shqiptuara në këto raste duhet të jenë në proporcion me shkallën e lartë të rrezikshmërisë shoqërore të këtyre veprave penale.

Ashtu që gjykata ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar të akuzuarit është në përputhje me peshën e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë. Gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit në

parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, dhe të bëj rehabilitimin e tij, por ai duhet të ndikoj edhe si preventivë e përgjithshme për personat tjerë që t'i parandaloj nga kryerja e këtyre veprave penale, të gjitha këto të parapara me nenin 41 të KPRK-së.

Vendimi mbi llogaritjen e arrestit shtëpiak në dënimin e shqiptuar u muar në kuptim të nenit 83 par.1 të KPRK-së.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarve për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontest civil është marrë në kuptim të nenit 463 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor u muar në bazë të nenit 450 par. 1 dhe 2 pika 2.1. dhe 2.6 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPPRK-së.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 365 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË**  
**Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni penal**  
**PKa.nr.158/10,dt. 05.03.2015**

**Sekretare Juridike**  
Mihrie Sheholli

**Gjyqtari i vetëm gjykues**  
Gazmend Bahtiri

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet Ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë e nëpërmes kësaj Gjykate.